



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ERMAL XH. HAMZAJ
ADRESA Rruga: "Pashko Vasa", Pallati
Nr.8, Shk.1, Zyra 5, Kt.2 Njesia
Bashkiake Nr. 5
TEL: 698227426

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 518

Nr. koleksioni: 256

Tirane më 28/01/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021053150026260063

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERËVE
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
Noter Ermal Xh.HAMZAJ

Nr. 518 Rep.

Nr. 259 Kol.

KONTRATE
SHITJE KUOTASH



Në Tiranë, sot në datën 28/07/2021 (dymijë e njëzetë e një), përpara meje noter Ermal Xh. Hamzaj, Anetar i Dhomës së Noterisë Tiranë, me licensë profesionale Nr.511, me zyrë noteriale të ndodhur në adresën Rruga: "Pashko Vasa", Pallati Nr.8, Shk.1, Kati 2, Zyra 5, Njësia Bashkiake Nr. 5, u paraqitën personalisht palët e mëposhtme:

Z.Giancarmine Battigaglia, atësia Francesco, i datëlindjes 26/09/1977, lindur në Crotone (Itali), madhor, me zotësinë e plotë për të vepruar, shtetas Italian, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal YB5472050 referuar më poshtë si "Shitësi";

dhe

Z.Bukurosh Stafa, atësia Ndricim, i datëlindjes 26/07/1951, lindur në Elbasan dhe banues në Elbasan, shtetas Shqiptar, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit Pasaporte nr. Personal F10726034D ; referuar më poshtë si "Blerësi".

MEQËNËSE ekzistojnë faktet:

Z.Giancarmine Battigaglia, është ortak i shoqërisë "**Vires & Flavor**" SHPK, shoqëri tregtare e të drejtës shqiptare, me NIPT(NUIS) L81925008H , dhe zotëron 55% të kuotave të shoqërisë "**Vires & Flavor**" SHPK,

Z.Giancarmine Battigaglia, dëshiron ti shesë 4% të kontributeve totale të shoqërisë, ortakut të ri, **Z.Bukurosh Stafa**, sipas kushteve të mëposhtme :

Z.Bukurosh Stafa dëshiron të blejë nga **Z.Giancarmine Battigaglia** 4% të kuotave totale të shoqërisë "**Vires & Flavor**" SHPK, sipas kushteve të mëposhtme.

Nisur sa më sipër, palët, me vullnet të lirë dhe të plotë, më kërkuan mua noterit hartimin e kësaj "Kontratë shitje kuotash", me përmbajtjen si më poshtë :

Neni 1

Qëllimi i kontratës

- Qëllimi i kësaj kontrate është transferimi 4% të kontributeve totale të shoqërisë "**Vires & Flavor**" SHPK, nga shitësi, tek blerësi.
- Kjo kontratë shërben për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrës së tranferimit të pronësisë dhe pagesës përkatëse lidhur me këtë transferim në përputhje me legjislacionin përkatës.

Neni 2

Objekti i kontratës

- Nëpërmjet kësaj kontrate, shitësi transferon në favor të blerësit 4% të kontributeve totale të shoqërisë si më poshtë të përcaktuara:

- **Z.Giancarmine Battigaglia** i shet 4% të kontributeve totale të shoqërisë ortakut të ri,
Z.Bukurosh Stafa;

Neni 3

Çmimi dhe menyra e pagimit

-Të dyja palët kanë rënë dakort midis tyre që çmimi i shitjes të kontributeve që shitësi transferon në favor të blerësit do të jetë në total **500 Euro (pesëqind Euro)**, konkretisht:

- **Z.Bukurosh Stafa** i ka paguar **Z.Giancarmine Battigaglia** , **500 Euro (pesëqind Euro)** për kuotën që përfaqëson **4 % të kapitalit të shoqërisë**;

-Po ashtu, të dyja palët deklarojnë se shumatat e mësipërme i është shlyer përkatësisht **Z. Giancarmine Battigaglia**, përpara nënshkrimit të kësaj kontrate, jashtë zyrës noteriale dhe se palet nuk kanë asnjë pretendim financiar kundrejt njeri-tjetrit.

Neni 4

Përgjegjësitë dhe garancitë e palëve

Shitësi, nëpërmjet kësaj kontratë shitje kuotash garanton si më poshtë:

- a) se është i vetmi titullar i ligjshëm i kontributeve që po transferohen me këtë kontratë shitje;
- b) se kontributet objekt shitje janë plotësisht të lira nga çdo barrë, detyrim, të drejta reale apo çdo lloj kufizimi tjetër;
- c) se transferimi i këtyre kontributeve në drejtim të blerësit është bërë në pajtim të plotë me ligjin tregtar në fuqi dhe dispozitat statutore;
- d) se shoqëria ka zhvilluar aktivitetin e saj në konformitet me ligjin;

NENI 5

Efektet e kontratës

-Kjo kontratë ka fuqinë e ligjit për palët nga momenti i nënshkrimit të saj përpara noterit dhe mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim dy-palëshe.

-Kontrata ka efekt për palët e treta në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

NENI 6

Informacioni konfidencial

-Palët detyrohen të mbajnë konfidencial të gjithë dokumentacionin, të dhënat dhe cdo informacion të përfituar gjatë marrëdhënies së tyre në shoqëri apo dhe referuar marrëdhënies konkrete të krijuar me këtë kontratë.

NENI 7

Transferimi i të drejtave

-Menjëherë mbas nënshkrimit të palëve, kontrata do të depozitohet dhe regjistrohet nga blerësia pranë regjistrimit tregtar të QKB.

-Me nënshkrimin e kësaj kontrate, kapitali i shoqërisë "Vires & Flavor" SHPK do t'i përkasë tre ortakëve, si më poshtë:

- **Z. Giancarmine Battigaglia**, zotërues i kuotës, që përfaqëson **51 % të kapitalit të Shoqërisë "Vires & Flavor" SHPK**;
- **Z. Bukurosh Stafa**, zotërues i kuotës, që përfaqëson **4 % të kapitalit të Shoqërisë "Vires & Flavor" SHPK**;
- **Z.Elton Ahmeti**, zotërues i kuotës, që përfaqëson **45 % të kapitalit të Shoqërisë "Vires & Flavor" SHPK**, në vlerë kapitali **45 LEKË (dyzet e pesë) lek**.

NENI 8

Ligji i aplikueshëm, zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- Kontrata është hartuar në përputhje me Legjislacionin tregtar në fuqi.
- Blerësi dhe shitësi angazhohen të bëjnë cdo përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konfliktet të mundshme që mund të krijohen midis tyre, lidhur me këtë kontratë nëpërmjet negociemeve të drejtëpërdrejta.
- Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikteve midis tyre, çështja do t'i nënshtrohet juridiksionit gjyqësor përkatës.

NENI 9

Dispozita përfundimtare

- Kjo kontratë është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë ligjore nga një për secilën palë, e cila ju lexua me zë të lartë e të qartë palëve nga unë noteri në gjuhën Italiane.
- Palët deklaruan se e dëgjuan, e kuptuan dhe meqënëse kontrata është hartuar në përputhje me vullnetin e tyre dhe ligjin, e nënshkruan personalisht dhe pa vërejtje përpara meje noterit.
- Pas nënshkrimit të palëve, unë noteri e nënshkrova dhe e vërtetova kontratën sipas kërkesave të Ligjit Nr.110/2018, datë 20/12/2018 "Për Noterinë".


PALËT KONTRAKTORE

SHITËSI

Z. Giancarmine Battigaglia

BLERËSI

Z. Bukurosh Stafa





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E
SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”**

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L81925008H
2. Data e Regjistrimit	25/07/2018
3. Emri i Subjektit	VIRES & FLAVOR
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	23/07/2018
6. Kohëzgjatja	Nga: 23/07/2018
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.5, Rruga Ismail Qemali, Ndertesa 14. Apartamenti 5, Hyrja 5,
8. Kapitali	100,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Pjesmarrjen ne kapitalin aksioner nepermjet zoterimit te kuotave, aksioneve , obligacioneve dhe cfaredo titulli tjetër privat apo publik, edhe ne cilesine e drejtuesil te grupit, te pjesmarresve ne kapitalin e shoqerive, te kapitalit dhe te cfaredo personi tjetër juridik, sidomos ne fushen e restoranteve, berrarise, bar, rosticeri, piceri, pasticeri, likere dhe pije te tjera analokolike dhe alokolike. Shoqeria mund te zhvilloje cdo aktivitet te perpunimit dhe tregtimit dhe ushqimeve dhe pijeve. Aktivitet organizativ me qellim koordinimin e proceseve dhe strukturave te shoqerive te treta dhe/ose te lidhura apo te kontrolluara. Blerjen, shitjen, shkembimin si dhe administrimin e pasurive te paluajtshme te cdo lloji, perdorimin e tyre ne cdo forme te lejuar, qiramarrjen dhe qiradhenien, ndertimin e objekteve civile, industriale apo edhe agrare, si dhe cdo te drejte tjetër mbi pronen. Shoqeria, ne ato raste kur lind nevoja me qellim realizimin e objektit te aktivitetit, mundet te kryeje cdo lloj operacioni tregtar, financiar, industriale, mobiliare, imobiliare, te ofroje garanci edhe ne favor te te treteve dhe te marre pjese me qellim investimi afatgjate , pjesmarrje ne



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT



shoqeri te tjera. Te tjera veprimtari te rastesishme te lejuara nga ligji. Shitje, blerje, dhe dhenie ne perdorim sipas 2 kontratave te parashikuara nga ligji, i know-how, royalties, markave, etj. Prodhimi, shperndarja me pakice dhe shumice, import-eksport e pices se konfeksionuar dhe jo vetem. Prodhimi, shperndarja, import-eksport dhe shitja e bukes dhe e prodhimeve te brumit te fresket dhe te paketuara. Prodhimi, shperndarja dhe shitja e artikujve te fresket pasticerie dhe te paketuara. Prodhimi, shperndarja dhe shitja e fetave te thekura dhe biskotave, produkteve te pasticerise te konservuar. Shoqeria mund te kryej gjithashtu ne kufijte qe lejojne ligjet ne fuqi te gjitha operacionet tregtare, mobiliare, imobiliare, financiare e industrial qe do ti konsideroj te dobishme per arritjen e objektit te shoqerise si dhe mund te interesohet dhe te marre pjese, ne shoqeri te tjera qe kane te njejtat qellime, analoge apo plotesuese me te. Ne fund shoqeria mund te kryeje çdo lloj forme financimi me entet publike, institutet e kreditit, bankat, shoqerite dhe private, duke leshuar garanci reale e personale, si dhe duke dhene besim, avale e garanci reale ne favor te te treteve. Shoqeria mund te marre dhe jape perfaqesime dhe agjensi, edhe ne shoqeri te huaja, ne lidhje me sherbimet dhe produktet e trajtuara. Vetem per qellimin e arritjes se objektit te shoqerise, jo per qellime kolokimi, dhe qe kjo te mos perbeje aktivitetin mbizoterues, shoqeria mund te marre pjesemarrje dhe kuota ne shoqeri te tjera me qellime te ngjashme ose analoge ose sido qofte te lidhura me te vetin. Shoqeria mund te beje te gjitha aktivitetet tregtare, industriale, financiare, mobiliare dhe imobiliare qe do te konsiderohen nga organi administrativ instrumentale, aksesore te lidhura, te nevojshme ose te dobishme per realizimin e aktiviteteve qe perbejne objektin e shoqerise. Shoqeria mund te marre pjese direkt ose indirekt ne ankande, tendera, ne sektorin publik ose privat, ne lidhje me dhenien e sherbimeve dhe punimeve te pershkruara ne objektin e shoqerise. Shoqeria mund te jete destinuese e financimeve dhe porosive nga ana e enteve kombetare dhe nderkombetare, publike dhe private, per aktivitetet promovimit industrial dhe per zhvillimin e ndermarjeve si edhe per aktivitetet e tjera ne lidhje me objektin e shoqerise. Per kryerjen e aktiviteteve shoqeria do te shfrytëzoje edhe

Kopje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	suportin e profesionistëve rregullisht të regjistruar në urdhrat profesionale në respektim të dispozitave ligjore në këtë fushë.	
10. Administratori/ët	Giancarmine Battigaglia	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 23/07/2018	Deri: 23/07/2023
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Giancarmine Battigaglia	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 55,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	55,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
13. Ortakët	Elton Ahmeti	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 45,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	45,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: VIRES & FLAVOR E-Mail: giancarmine.b@libero.it elton.ahmeti@libero.it Telefon: 0699903006	
16. Statusi:	Aktiv	

Datë: 28/01/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

REZULTATET E KËRKIMIT



Numri i Rezultatit të Kerkimit:	D-20210126161335458
Data e Rezultatit të Kerkimit:	26.01.2021
Ora e Rezultatit të Kerkimit:	4:13:35PM
Lloji i Kerkimit:	
Numri i Dokumentit:	D-400-113-1612
Referenca e Perdoruesit:	

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

GIANCARMINE FRANCESKO BATTIGAGLIA
VIRES & FLAVOR SH.P.K.



Armando Ioku



Tirane, __/__/2021

SHOQERIA: "Vires & Flavor" SHPK

NIPT: L81925008H

Adresa: Rruga Ismail Qemali, Njesia Administrative nr 5, Tirane

Autorizim

Une, Z.Giancarmine Battigaglia, i identifikuar me Leternjoftimin nr. YB547205O_ne cilesine e Administratorit te shoqerise "Vires & Flavor" autorizoj Z. Bledar Brami, me nr ID I30511063J, për të kryer veprime prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Administratori

Z.Giancarmine Battigaglia

